

Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 14.08.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.08.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "GRAMI SHPK" për aktivitetin: "Furnizim me makina pastrimi" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2020-121 nxjerr:

VENDIM

Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Grami SHPK" e datës 10.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i QMF-se ne Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 06.08.2020, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Anulohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 07.08.2020 dhe aktiviteti kthehet ne rivlereresim;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "**Grami SHPK**" me datë 10.08.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizim me makina pastrimi**" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-2020-121

Autoriteti Kontraktues, me datë 14.08.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet lidhur me plotesimin e kerkesave teknike te paisjeve te ofruara nga tenderuesi i propozuara per dhenje te kontrates jane te bazuara, pasi qe eshte konstatuar se ne kerkesen e AK-se ne Aneksin 1 eshte kerkuar makinat te kene mbushesin e integruar te baterive, ndersa nga katalogu shihet se paisja e ofruar eshte makine qe duhet te perdor kabllin per furnizim me energji. Ne katalogun e ketij prodhuesi ka edhe tipe tjera te prodhuara, por ka nevojë qe

vleresimin se a pershtatet ndonje me kerkesat tona duhet ta beje nje ekip profesional,e qe ne vleresimin paraprak kjo ka munguar.

Rekomandoj qe ne fazen e rivleresimit te formohet nje komision profesional ne menyre qe te vleresoj sakte pershtatshmerine teknike te paisjeve te ofruara nga tenderuesit.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

